



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 30.01.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 30.01.2025, të parashtruar nga "BBG CAPITAL" sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rrënimi dhe ekzekutimi i objekteve pa leje në Komunën e Gjakovës", Nr. i prokurimit- 632-24-12691-2-1-1, Nr. i brendshëm 632-24-133-211, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e vonuar- jashtë afatit kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik "BBG CAPITAL" sh.p.k., e dt.30.01.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rrënimi dhe ekzekutimi i objekteve pa leje në Komunën e Gjakovës", Nr. i prokurimit- 632-24-12691-2-1-1, Nr. i brendshëm 632-24-133-211, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 22.01.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË**, të publikuar me datë: 22.01.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori ekonomik "BBG CAPITAL" sh.p.k. me dt.30.01.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rrënimi dhe ekzekutimi i objekteve pa leje në



Komunën e Gjakovës “ , Nr. i prokurimit- 632-24-12691-2-1-1, Nr. i brendshëm 632-24-133-211.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 30.01.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Kërkesa juaj për rishqyrtim, është dorëzuar me dt.30.01.2025, kurse dorëzimi I ofertave-hapja e tenderit do të bëhet me dt.31.01.2025, prandaj e njejta refuzohet si e vonuar, sepse nuk është dorëzuar brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 60.1 (a), të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024:

60.1 Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni “ kërkesat për rishqyrtim” brenda afateve të mëposhtme:

a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Guta

Menaxher i Zyrës së Prokurimit
